

VENDIM
Nr. 171, datë 26.10.2017

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“SIMA - COM” SHPK, PËR LICENCIM NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-I “MESHURDH”, ME FUQI TË INSTALUAR 1.3
MW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “a” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, neneve 4, pika 1, germa “a”; 5, pika 1, germa “a” dhe 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.10.2017, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Sima - Com” sh.p.k,

konstatoi se:

Shoqëria “Sima - Com” sh.p.k., me shkresën nr. 657 prot. i ERE-s, datë 6.10.2017, ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i Meshurdh, me fuqi të instaluar 1.3 mw.

Aplikimi i shoqërisë “Sima - Com” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat (“a”, “b”, “d”, “e”, “f” dhe “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për HEC (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, gjerat “a”, “c” dhe “d”; 4.1.4; 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Një diagram elektrik në format A1 të aggregateve dhe bllokut të transformimit, ku të evidentohen qartë pika e lidhjes me sistemin dhe pika e matjes (neni 9, pika 4.1.3, germa “b”); do të njoftohet subjekti që, në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Sima – Com” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-i “Meshurdh”, me fuqi të instaluar 1.3 mw.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike

nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti